Kronikë

EMRI/ Plagosje me armë në Kurbin, 30-vjeçari qëllon me pistoletë kushëririn

Një konflikt mes dy personave është shoqëruar me të shtëna me armë zjarri në Kurbin dhe plagosjen e njërit prej tyre

HOROSKOPI

Elvis Hila
30 Dhjetor, 07:28 | **Përditesimi: 30 Dhjetor, 13:10**

Share

Një konflikt mes tre kushërinjve në Kurbin u shoqërua me të shtëna me armë zjarri dhe plagosjen e njërit prej tyre.

Ngjarja ndodhi mesnatën e së premtes në një lokal në fshatin Malbardhe të Kurbinit, ndërsa i plagosur mbeti Fatjon Lika 33-vjeç banues në Kurbin. Ky i fundit u qëllua me armë zjarri pistolete nga Admir Shqypi (Lika).

Nga të shtënat 33-vjeçari mori një plumb në pjesën e barkut dhe pasi mori ndihmën e parë mjekësore në Spitalin e Laçit, u dërgua për ndihmë më të specializuar mjekësore në Spitalin e Traumës në Tiranë nga ku mësohet se ndodhet nën kujdesin e bluzave të bardha jashtë rrezikut për jetën.

LEXO EDHE:
Fundviti, trafik i rënduar në Lezhë, situata më problematike në hyrjen e dalje të qytetit dhe pranë tregut

Policia e cila mbërriti menjëherë në vendin e ngjarjes arriti të identifikoje autorin 30-vjeçarin Admir Shqypi (Lika), i cili ka ndërruar mbiemrin si pasojë e një konflikti të hershëm dhe dy personat e tjerë të përfshire shtetasit E.L dhe P.L.

Ata janë shpallur në kërkim dhe forcat e policisë vijojnë kontrollet e pandërprera për prangosjen e tyre.

Ndërkohë motivet e ngjarjes mbeten ende të paqarta, por pritet marrja në pyetje e të plagosurit dhe personave të tjerë për të zbardhur ngjarjen nga ku mbeti i plagosur me arme zjarri 33-vjeçari Fatjon Lika.

M.Q./KT/Shqiptarja.com

TAG: Lezhë | Kurbin | plagosje | admir lika | fatjon lika

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Arrest shtëpie e ndalim komunikimi me jashtë për Berishën, si e vlerësoni?
Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera



Vrasja e Ardian Nikulajt/ U arrestua në Marok, vrasësi i biznesmenit pritet të ekstradohet sot në Shqipëri
31 Dhjetor, 09:46

Fundviti, abuzime me çmimet në Lezhë
Elvis Hila
31 Dhjetor, 09:24

Rama publikon pamjet: Bashkia e re e Kurbinit, shembëltyrë e transformimit rrënjësor të qytetit të rilindur
30 Dhjetor, 19:17

Muzikë e koncerte për festa në Shkodër, Durrës, Lezhë e Vlorë
30 Dhjetor, 17:11

Lezhë/ Automjeti përplas biçikletën, plagoset rëndë çiklisti
30 Dhjetor, 13:48



Vrasja e biznesmenit Ardian Nikulaj në Shëngjin, Foto e Ruben Saraivas në Marok, me pranga në duar pret ekstradimin
Elvis Hila
30 Dhjetor, 11:24

'Gaz-jeta', muzike dhe humor në Lezhë! Aktori lezhjan Nikolin Delia vjen për publikun me një koncert recital
Elvis Hila
30 Dhjetor, 10:18

Lezhë/ Basketbollistët e Besëlidhjes surprizojnë vajzat jetime me dhurata për festat e fundvitit
29 Dhjetor, 16:51

Reforma, 40 punëtorë mbeten pa punë në Portin e Shëngjinit
Elvis Hila
29 Dhjetor, 11:48

Borxhet, bashkia e Lezhës u fal 30 milionë lekë bizneseve: Gjoba të vendosura nga KLSH para një dekade
Elvis Hila
28 Dhjetor, 16:05

Ambiente të kufizuara dhe vonesa në gjykim në Lezhë, avokatët: Harta e re gjyqësore ka shtuar kaosin! Aurel Arapi: Problem kryesor mbetet mungesa e hapësirës
27 Dhjetor, 22:02

Kurbin/ Qëlloi me pushkë drejt një banese dhe rrezikoi familjen, 41-vjeçari u arratis në pyll! Arrestohet pas ndjekjes nga RENEA
27 Dhjetor, 11:00

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje